



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 855/2 prot:

Pukë, më 04.06.2024

VENDIM

Nr. 23 datë 29.05.2024

PER

Per korrighimin e vendimin e keshillit bashkiak Nr.64 date 23/10/2019
Per miratimin e heqjes nga fondi pyjore publik te siperfaqjes 0.15 ha qe do perdoret per ndertimin e HEC Gomsiqe e Eperme bashkia Puke .

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Ligjin nr.8480, date 27.05.1999 “Per funksionimin e organeve kolegjiale te administrates shtetore dhe enteve publike”, Ligjin nr.107/2014 date 31.07.2014 “Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ne Ligjin nr.43 date 30.04.2015 “Per sektorin e energjise elektrike ” i ndryshuar , ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 433 date 08.06.2016 “Per transferimin ne pronesi te Bashkive te fondit pyjor e kullisor publik.”, V.K.M-ve nr 888,datë 27.12.2022, “Për rastet e dhenjes ne perdorimi dhe per ndryshimin e kategorise se perdorimit ,procedurat dhe dekumentacioni perkates per ndryshimin e siperfaqeve dhe paksimin ne volum nga fondi pyjor kombetar apa zgjerimin e tyre; VKM-ve nr. 559, datë 29.07.2022 “Përpërcaktimin e cmimeve tarifave per dhenjen ne shfrytezim/Perdorim te fondit pyjor kombetar per veprimtari ekonomike si dhe per prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore 1374, date 10.10.2008 “Per percaktimin e rregullave dhe te procedurave qe ndiqen per heqjen, shtimin dhen dryshimin e destinacionit te fondit kullisor” Udhezimin e Ministris te Mjedisit Nr. 1 date 09.06.2016 “Per rregullat, procedurat e kerkimit, te shqyrtimit e miratimit te kerkesave per dhenie ne perdorim te fondit pyjor dhe kullisor publik”,si dhe Shkresen Nr.374 prot.date 15.01.2024 te Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit Drejtoria e Pergjithshme per Zhvillimin e Mjedisit,Drejtoria e Mjedisit dhe Pyjeve ku kerkohet korrighimi i vendimit.
Me propozim te Kryetarit te Bashkise:

VENDOSI:

1. Te miratoje korrighimin ne piken 2 te vendimin Nr.64 date 23/10/2019 si me poshte:Ne piken 2 te vendimit nr.64 date 23/10/2019 behet korrighimi sipas raportit teknik-ekonomik duke pasqyruar parcelen nr.110/a ne ekonomine pyjore Gomsiqe ne pronesi te Bashkise Puke”

2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari Bashkise dhe Drejtori e menagjimit te Pyjet e kullotat,dhe Bujqesine.
3. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 pika 6,e ligjit nr 139/2015"Per veteqeverisjen vendore"
4. Shpallur me date

Miratuar me 10 vota pro,Vota Pro 10, Vota Kunder 0 , Vota Abstenim 0 .

SEKRETAR

Hazbi **TERBUNI**



KRYETARI I KESHILLIT

Eduard **GJOKA**





01.07.24

SEC/Keshilli
e u procedurave



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 418/1 Prot.

Keshilli 855/4

26.06.2024



Shkodër, më 24.06.2024

Lënda: Mbi Vendimin nr. 23, datë 29.05.2024 të Këshillit Bashkiak Pukë

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", i ndryshuar, neni 56, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja "a", neni 27, pika 5, neni 54, shkronja "e/1", neni 55, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", neni 25, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", të ndryshuar, pika 50, shtojca 48, të VKM nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe prodhime drusore dhe jodrusore pyjore", lidhja 1, tabela 6, të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", pikat 7, 8 dhe 9, të shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr. 374/2 prot., datë 15.01.2024 "Mbi rregullimin e Vendimit e Këshillit Bashkiak për ndërtimin e Hec-it", shqyrtoi VKB Pukë nr. 23, datë 29.05.2024 "Për korrigjimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 64, datë 23.10.2019 Për miratimin e heqjes nga fondi pyjor publik të sipërfaqes 0.15 ha që do të përdoret për ndërtimin e HEC Gomsiqe e Epërme, Bashkia Pukë", për korrigjimin e pikës 2 të vendimit duke shtuar ngastrën nr. 110/a, të ekonomisë pyjore Gomsiqe, sipas kërkesës të shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr. 374/2 prot., datë 15.01.2024 "Mbi rregullimin e Vendimit e Këshillit Bashkiak për ndërtimin e Hec-it".

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedimin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKT

Majlinda ANÇONI